



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2023:109722

Datë: 29.02.2024

Numri i dokumentit: 05394125

**C.nr.1568/2023**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, Divizioni Civil,** gjyqtarja Edije Sezairi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit B.D. nga Prizreni, me numër personal ..... të cilin me autorizim e përfaqësonë av. B.K. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor i Komunës V.J.Xh. me objekt të padisë kompensimi i shujtave, vlera e kontestit 136.00 €, jashtë shqyrtimit gjyqësor, me datë 25.02.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

- I. APROVOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditësit B.D. nga Prizreni, si e bazuar, **DETYROHET** e paditura, Komuna e Prizrenit- Drejtoria Komunale e Arsimit, në Prizren, që paditësit B.D. nga Prizreni, në emër të kompensimit të shujtave për 68 ditë pune, për vitin 2022, të paguaj shumën prej nga 2 (dy) euro në ditë, apo shumën e përgjithshme prej 136.00 €, me kamatë ligjore prej 8% në nivel vjetor, e cila fillon të rrjedhë nga data e paraqitjes së padisë 16.05.2023, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit të detyrueshëm.
- II. DETYROHET** e paditura që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 125.00 €, në afat prej 7 ditësh nga pranimi i këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të detyrueshëm

**A r s y e t i m**

Paditësi B.D. nga Prizreni, përmes të autorizuarit të tij av. B.K. nga Prizreni, pranë kësaj gjykate, me datën 16.05.2023, ka parashtruar padi, kundër të paditurës Komuna e Prizrenit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt të padisë kompensimin shujtave ditore.

I autorizuari i paditësit, në padi kanë theksuar se paditësi është mësimdhënës pranë SHMM "Luciano Motroni" në Prizren dhe i takon kompensimi për shujtat ditore për vitin 2022, nga 2 euro në ditë për çdo ditë pune. Ashtu siq parashihet me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë. Edhe pse paditësi i është drejtuar të paditurës lidhur me kompensimin për ditët e punës, e njëjta nuk ka marrë përgjigje. Prandaj gjykatës i ka propozuar,

që e njejta të merr aktgjykim dhe padinë e kërkesëpadinë e paditësit, ta aprovojë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes të përfaqësueses ligjore të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses lidhur me kompensimin nga marrëdhënia e punës. E njejta ka theksuar se bazuar në njoftimin e Ministrisë, Shkencë, Teknologjisë dhe Inovacionit nr. 01B/488, të datës 21.11.2021, për Shkëputjen e Kontratës Kolektive të Arsimit, të datës 22.01.2021, padia dhe kërkesëpadia e paditësit është e pa bazuar. Po ashtu theksuar se përfitues të beneficioneve që rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit janë vetëm antarët e Sindikatës së Arsimit – SBASHK, ndërsa paditësi nuk ka ofruar ndonjë provë që është anëtarë i sindikatës. Sipas saj, të paditurës nga ana e Ministrisë së Financave nuk i është ndarë kod buxhetor për përmbushjen e obligimeve që dalin nga Kontrata Kolektive e Arsimit në Kosovë e datës 18.04.2017, andaj e njëjta nuk ka mundësi ligjore për të përmbushur këtë obligim, pasi që bie në kundërshtim me Ligjin për Buxhetin Nr.08/L-193. Gjithashtu e paditura ka theksuar se padia e paditësit është në kundërshtim me nenin 90 par.1.1 dhe 1.2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, pasi sipas këtyre dispozitave marrëveshja kolektive lidhet mes organizatës së punëdhënësit dhe organizatës së të punësuarve, ndërsa në këtë rast Komuna e Prizrenit është punëdhënësi dhe nuk mund të obligohet në përmbushjen e kësaj kontrate, pa qenë pale nënshkruese e saj. Në fund ka kërkuar nga gjykata, që padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzojë si të pabazuar

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 152 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e themeltë, andaj pa shqyrtim të çështjes, e aprovoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Mes palëve nuk rezulton të jetë kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, përkatësisht në SHMM “Luciano Motroni” në Prizren.

Nga vërtetimi me numër të references 254/5, të datës 28.02.2023, të lëshuar nga ana e drejtorit të SHMM “Luciano Motroni” në Prizren, gjykata vërtetoi faktin se paditësi B.D. nga Prizreni, është në marrëdhënie pune pranë SHMM “Luciano Motroni” në Prizren, dhe gjatë vitit 2022, ka gjithsej 68 ditë pune.

Vërtetimin e lartcekur, Gjykata e pranoi si provë materiale vendimtare, në kuptim të nenit 329 par.1, të LPK-së, në të cilin paragraf përcaktohet se “*Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të*”. Andaj pasi që vërtetimi i lartcekur është lëshuar nga vet e paditura brenda fushëveprimit të saj, e i cili si i tillë është i pranueshëm edhe për vetë palën e paditur, ashtu që vërtetimit me numër të references 254/5, të dates 28.02.2023, gjykata i’a fali besimin e plotë, si provë me të cilën vërtetohet fakti lidhur me vendin e punës dhe ditët e punës, konkretisht paditësi B.D. nga Prizreni, është në marrëdhënie pune pranë SHMM “Luciano Motroni” në Prizren dhe gjatë vitit 2022, i ka gjithësej 68 ditë pune.

Bazuar në faktet e çështjes, Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, me nr.01/B, nr. prot. 105, e dt.22.01.2021, të nënshkruar në mes të Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës, e cila ka hyrë në fuqi me datë 22.01.2021.

Me nenin 35 par.7, të Kontratës Kolektive të Arsimit, nr.01/B, nr. prot. 105, e datës 22.01.2021, është përcaktuar e drejta e punëtorëve në kompensimin e shujtave dhe atë *“Të punësuarve (antarë të SBAShK-ut), u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimeve të ushqimit në punë, për një ditë pune, është dy euro për të punësuarit të cilët kanë marrëdhënie pune primare në institucionet arsimore...”*.

Gjykata me rastin e vendosjes, jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 152 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton: *“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim (neni 143 dhe 147 të këtij ligji), nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij.”*, pasi që e paditura ka pasur për detyrim që paditësit si punëtor i arsimit-mësimdhënës, t’ia paguaj kompensimin e shujtave, konform detyrimeve që rrjedhin nga dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit, neni 35 paragrafi 7, pasi që për paditësi B.D. nga Prizreni, kërkesa është bërë e arritshme për 68 ditë pune, gjatë vitit 2022, apo shuma e përgjithshme prej 136.00 €.

Sa i përket kundërshtimeve të paditurës me përgjigj në padi, Gjykata vlerëson se të njëjtat nuk janë të bazuara mbi dispozitat ligjore dhe nuk mbështeten në ndonjë bazë faktike apo juridike, ndërsa çështja e mënyrës së pagesës, respektivisht mundësisë së pagesës nga ana e të paditurës nuk është rrethanë e natyrës juridike. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet nuk ishin kontestuese dhe nuk ekzistojnë pengesa për dhënien e vendimit meritor.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse dhe duke llogaritur kamatën ligjore si në dispozitiv, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, duke e llogaritur të njëjtën nga dita e parashtrimit të padisë në këtë gjykatë (16.05.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020, të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditura është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në dispozitat e nenit 449, 452 dhe 453.2 të LPK-së, sipas Tarifës së Odës së Avokatëve, lartësia e shpenzimeve i referohet përpilimit të padisë në shumën prej 104 euro dhe taksës gjyqësore në shumën prej 21 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 125 euro.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e nenit 152 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN**  
**Departamenti i Përgjithshëm**  
**C.nr.1568/23, datë 25.02.2024**

**Gjyqtarja,**  
**Edije Sezairi**

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve nga dita e pranimi pranë Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.